



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 155

Ora: 12:30

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 77, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "ALEANCA PROGRESISTE LZHK"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK", përfaqësuar nga z. Rizaldo Vrenozi dhe z. Fabian Topollari

**OBJEKT:**

- Ndryshim i vendimit nr. 74, datë 17.05.2023 i KZAZ nr. 15 Kurbin për shpalljen e pavlefshme të kutisë së QV nr. 0907.
- Numërimin e votave që gjenden në kutinë e QV nr. 0907, që i përket fshatit Shpërdhet, njësia administrative Mamurras, bashkia Kurbin.



**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 77 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 26.05.2023, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 77 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 77, datë 22.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 29.05.2023, ora 13:20.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>

